



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:221192
Datë: 12.09.2024
Numri i dokumentit: 06153564

K.Dh.Shk.II.nr.1514/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija - Ymeri, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Krenar Berisha anëtare të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të masës së sigurisë-paditësit A.... Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “...” nr.244, me NUI: ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Veton Robaj, me seli të zyrës në Prishtinë, kundër kundërshtarit të masës së sigurimit F...G.... Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “...”, me NUI: ..., të cilin e përfaqëson D.R., në cilësinë e drejtorit, për shkak të caktimit të masës së sigurisë, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit-paditësit, të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.792/23, i datës 29.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.11.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e propozuesit të sigurimit A.... Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “...” nr.244 dhe **ANULOHET** aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr. 792/23, i datës 29.05.2024, dhe lënda i kthehet në Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje ekonomike në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

1 (5)

Gjykata e shkallës së parë, në aktvendimin e ankimuar, ka vendosur si në vijim:

I “REFUZOHET në tërësi i pabazuar propozimi i propozuesit të masës së sigurisë A.... Sh.P.K., me seli ne Prishtine me të cilin ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit, ashtu që ndaj kundërshtarit të sigurimit F...G.... Sh.P.K., të urdhërohen të gjitha bankat komerciale në Kosovë ku kundërshtari i sigurimit ka të hapur xhirollogari, t’i bllokohet shuma prej 53,520.00 euro derisa të bëhet zgjidhja përfundimtare e kësaj çështje nga gjykata”.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka paraqit propozuesi i masës se sigurimit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale duke i propozuar gjykatës së shkallës së dytë që të aprovojë ankesën si të bazuar ta prish aktvendimin KE.nr. 792/23, i datës 29.05.2024, si dhe aprovohet në tërësi si i bazuar propozimi i propozuesit të masës së sigurisë. Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitë kundërshtari i masë së sigurisë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës secilin veç e veç dhe analizës së tyre si dhe pas shqyrtimit të aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore të propozuesit të masës së sigurisë, në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi - propozuesi i masës së sigurisë A.... Sh.P.K., me seli ne Prishtine, me datën 18.10.2023 pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur padi për kthimin e paradhënjes në shumë prej 45.000,00euro,si dhe kompensim dëmi dhe fitimi i humbur, njëherit ka paraqit edhe propozim për caktimin e masës së sigurisë ndaj kundërshtarit të sigurimit F...G.... Sh.P.K me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet propozimi për caktimin e masës së sigurisë të caktohet masa e të urdhërohen të gjitha bankat komerciale në Kosovë ku kundërshtari i sigurimit ka të hapur xhirollogarinë, të bëhet bllokimi i shumës prej 53,520.00 Euro derisa të bëhet zgjidhja përfundimtare e çështjes nga gjykata.

Gjykata e Shkallës së parë ka marrë aktvendimin e ankimuar me arsyetim se propozuesi i masës nuk ka arritur ta bëjë të besueshme plotësimin e dy kushteve në mënyrë kumulative siç përcaktohet me ligj përkatësisht ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të propozuesit dhe rrezikun apo dëmin që mund ti shkaktohet. Ndër të tjera ka cek se duke u bazuar në nenin 297 të LPK-së, për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen kushtet ligjore sipas të cilave propozuesi duhet ta bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës si dhe ta bëjë të besueshëm faktin se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së saj, e që në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuar me nenin e lartë cekur sepse propozuesi i masës së sigurisë nuk ka arritur ta argumentoi se ekziston rreziku se pala kundërshtare do të mund të ndërmarrë veprime me të cilat do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së tij, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të masës së sigurimit.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë duke ekzaminuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të ankesës, gjen se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë në këtë çështje juridike kontestuese tani për tani është i pa papranushëm, për arsye se ka gjetur se aktvendimi i ankimuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika n) të LPK-së.

Në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë nuk ka sqaruar fare se pse nuk janë plotësuar kushtet nga neni 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, ngase në tërë arsyetimin e aktvendimit të ankimuar vetëm është referuar në dispozitat e nenit 297 par. 1 pika a) dhe b) të LPK-së, por nuk është dhënë asnjë fakt i vërtetuar dhe asnjë arsye pse gjykata ka konsideruar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës siguroese. Sepse në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë flet se propozuesi nuk ka ofruar prova me të cilën do të mund të provohej se kundërshtari i sigurimit do të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, ndërsa në anën tjetër nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse si ka vlerësuar provat që gjinden në shkresa të lëndës si që janë detajet e transaksionit bankar e datës 10.07.2023 dhe datës 23.08.2023 të lëshuar nga NLB-Bankë dhe se këto detajet të transaksionit bankar a kanë të bëjnë me paradhënje ashtu si që pretendon propozuesi i masës së sigurisë. Andaj,

kolegji i dhomës së shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të qendrshme të qarta dhe konkrete se pse nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara me 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së në mënyrë kumulative. Thënë me konkretisht dhoma e shkallës së parë vetëm ka parafrazuar dispozitën e 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, ashtu si që ceket në 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së.

Pra krejt në fund, Gjykata e dhomës së shkallës së parë edhe njëherë të vlerësoj të cekurat në këtë aktvendim, të vlerësoj të gjitha provat dhe të nxjerrë vendim të drejtë të arsyetuar, një nga një për secilin fakt në mënyrë që të eliminohen shkeljet e cekura më lartë.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1514/24, me datën 11.09.2024

Kryetare e kolegjit
Franciska Zhitija Ymeri

Numri i lëndës: 2023:221192
Datë: 12.09.2024
Numri i dokumentit: 06153564